




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



J@B Net
Fitnete Mujaj
Drejtoresh
Pejë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/385 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
J@B Net (Palë përgjegjëse)**



Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave ka mandat ligjor rregullimin e të drejtës së transmetimit dhe ritransmetimit, obligim ky nga Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatësisht nga neni 30, i cili përcakton se Shërbimet mediale audiovizuale, operatorët kabllorë dhe operatorët tjerë që pavarësisht teknologjisë së përdorur ofrojnë përmbajtje audiovizuale, obligohen të bëjnë transmetimin dhe ritransmetimin e programeve bazuar në marrëveshjet valide për të drejtën e autorit, të cilat do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar në shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave, të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës.
2. Bazuar në nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audio vizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave.
3. Rregullorja KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale ka përcaktuar se pas funksionalizimit të shoqatave për menaxhimin kolektiv të të drejtave, marrëveshjet mbi të drejtën e autorit do të pranohen vetëm pasi ato të jenë regjistruar në këto shoqata.
4. Në bazë të Vendimit 12/36 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 19 tetor 2020, i plotësuar me Vendimin 13/38 të datës 30 tetor 2020, janë përcaktuar tarifat për të drejtat e autorit dhe është hapë rruga që operatorët e shpërndarjes të procedojnë tutje me regjistrimin e marrëveshjeve për të drejtat e autorit në shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit.
5. KPM me datën 2 nëntor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse shkresë përmes së cilës i ka kërkuar që në afat prej (30) ditëve, nga dita e pranimi të shkresës, të bëjnë regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në transmetim nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë dhe për këtë ta njoftojnë KPM në lidhje me veprimet që kanë

ndërmarrë për të vepruar në pajtim me nenin 30, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

6. KPM edhe pas afatit të përcaktuar ligjor nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse në lidhje me shkresën e dërguar.

Analiza ligjore

7. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili përcakton se:

“Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audiovizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.”

8. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, pasi që edhe pas afatit (30) ditor të dhënë nga ana e KPM-së për regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në transmetim, nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për regjistrimin e tyre në shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit.
9. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Vendim

10. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.
11. Obligohet Pala përgjegjëse, që në afat brenda (15) ditëve nga dita e pranimit të Vendimit, të bëjë regjistrimin e të gjitha marrëveshjeve për kanalet të cilat janë në transmetim nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë dhe ta njoftojë KPM-në në lidhje me veprimet që ka ndërmarrë për të vepruar në pajtim me nenin 30, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

E drejta për ankesë

12. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat Latifi
Kryetar



12.04.2022
Datë